



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Vau Dejes, më _____._____.2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Sistemim asfaltim rruga Shelqet-Kaçë”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45- Punë
ndertimore**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 48.208.333 (dyzet e tete milione e dyqind e tete mije e treqind e
tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH**

Fondi do të ndahet në vite, si më poshtë :

- Në total për vitin 2026, fondi është 20.890.018(njzet milione e teteqind e nentedhjetë mije e tetembedhjetë) lekë pa tvsh.
- Në total për vitin 2027, fondi është 10.631.986(dhjetë milione e gjashteqind e tridhjetë e një mije e nenteqind e tetedhjetë e gjashtë)lekë pa tvsh.
- Në total për vitin 2028, fondi është 16.686.329(gjashtembedhjetë milione e gjashteqind e tetedhjetë e gjashtë mije e treqind e njzet e nente)lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vau Dejes** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Në masën 2% të fondit limit, vlera 964.167(nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë)lek.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar , si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023,2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar , si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga

veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.2 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet konkretisht: **48.208.333 (dyzet e tete milione e dyqind e tete mije e treqind e tridhjetë e tre)**lekë pa TVSH. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026 (sipas kesteve të maturuara) sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. ((Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).

Mbështetur në nenin 26, pika 6 e VKM-së nr 285 , date 19.05.2021, në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.
).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Vau Dejes, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2.2.3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kesteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **24.104.166** (njëzet e katër milion e njëqind e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **96.416.666** (nëntëdhjetë e katër milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit; **(nese leshohet)**
 - Certifikaten e marrjes në dorezim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti; **(nese leshohet)**
 - Certifikaten e marrjes në dorezim/ Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
 - Fature tatimore perkatese të deklaruar në organet tatimore.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **24.104.166** (njëzet e katër milion e njëqind e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **96.416.666** (nëntëdhjetë e katër milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (2.3.2 a dhe 2.3.2 b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: ***”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.***

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.***

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: *”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, **autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.***

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi”

Kategoria NP-4 Niveli B “Rruge ,autostrada,mbikalime”

Punime speciale ndërtimi:

Kategoria NS-6 Niveli A “Sinjalistika rrugore jodriçuese”

Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”

- ❖ ***Parashikohet edhe mundësia e ekuivalentimit të licencave profesionale për operatorët e huaj.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë

10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore, perkatesisht si me poshte;

“N.P. 1 Punime gjurmimi në tokë

Konsiderohen **gjurmimet**, sistemimet dhe **ndryshimet në volum** të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.

N.P. 4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar **rrugët**, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të **mureve mbajtëse**, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, **betonarme të thjeshtë** dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndërjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore

N.S - 6: Sinjalistika rrugore jodriçuese

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e **sinjalistikës rrugore** jondriçuese, **vertikale, horizontale** dhe komplementare.

N.S - 18 Punime topogjeodezike

Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, **punime topogjeodezike në objekte inxhinierike**, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi	Shuma 1,2,6 e preventivit	Niveli A	936,954.88
<u>Kategoria NP-4</u>	Rruge ,autostrada,mbikalime	Shuma 3, 4, 5 , 9, e preventivit	Niveli B	40,568,578.76
<u>Kategoria NS-6</u>	“Sinjalistika rrugore jodriçuese”	Shuma 7 dhe 8 e preventivit	Niveli A	6,702,799.69
<u>Kategoria NS-18</u>	Punime topogjeodezike		Niveli A	

Shenim: Pika e licences për punime topogjeodezike është kërkuar për shkak se kemi të bëjmë me infrastrukturë rrugore dhe projekti parashikon përmirësim të gjeometrisë horizontale dhe vertikale të rrugës. Piketimi dhe kontrolli topografik duhet bërë në cdo fazë të zbatimit të punimeve.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik /Ing ndertimi të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- Librezë pune;
- Kontratë pune e vlefshme;
- Diplomë./ing ndertimi

(Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues).

Mbështetur në nenin 26, pika 6 e VKM-së nr 285 , date 19.05.2021, në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.3.a) Vetdeklarimin nga inxhinierat se ata janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020 “Mbi Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP”.

2.3.4 Kapaciteti Teknik dhe Profesional (Burimet Njerëzore)

2.3.4.1 Stafi inxhinierik dhe teknik:

a) 1 (një) inxhinier ndërtimi - drejtues teknik

Inxhinieri i ndërtimit duhet të jetë i pajisur me diplome dhe duhet të figurojë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë si dhe të disponojë kontrate pune të vlefshme.

Pergjegjesi teknik duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate me kohe pune te plote ne objekt , e cila do te bashkeshoqeroje deklaraten e subjektit.

(bazuar ne Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020 “Mbi Problematikat e konstatuara gjate monitorimit nga APP”.)

b) 1 (nje) inxhinier ndërtimi

Inxhinieri i ndërtimit duhet te jete i pajisur me kontrate pune te vlefshme dhe diplome.

Inxhinieri i ndërtimit duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se do te jete i disponueshem ne kantier gjate realizimit te kontrates.

c) 1 (nje) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder

Inxhinieri topograf/Gjeodet/Markshajder duhet te jete i pajisur me licence profesionale dhe kontrate pune te vlefshme.

Inxhinieri topograf duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Nga ana teknike, numri i burimeve njerëzore dhe stafi inxhinierik është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut të zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda **6 muajve** kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

Është kërkuar **inxhinier ndërtimi (Drejtues Teknik)** për zbatimin e punimeve në përputhje me zërat e preventivit, projektit dhe specifikimeve teknike. Drejtuesi teknik është përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës sipas projektit, kushteve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë. Gjithashtu, ai është përgjegjës për hartimin e projektit teknik 'As-Built' si dhe projektit të mirëmbajtjes së objektit në përfundim të punimeve. Krahas tij, është kërkuar një **Inxhinier Ndërtimi** me qëllim që të garantohet prania dhe ndjekja e përditshme teknike e punimeve në kantier, nën udhëzimet e drejtuesit teknik, pa krijuar vonesa në grafikun e zbatimit të projektuar nga studio “LENI-ING” shpk. Vetëdeklarimet e tyre të disponueshmërisë bazohen në Rekomandimin e APP-së Nr. 6732, datë 21.10.2020, për të shmangur angazhimet fiktive.

Është kërkuar **Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder** për kryerjen e punimeve topografike për nxjerrjen e kuotave të gërmimit, nivelimin e saktë të shtresave rrugore dhe sistemimin e kanaleve anësore.

2.3.4.2 Stafi i Punëtorëve të Specializuar dhe Fuqia Punëtore

*Për kryerjen e punimeve, numri i punonjësve (pa përfshirë stafin inxhinierik) duhet të jetë **minimalisht 7 (shtate) punonjës te cilet duhet të figurojnë në listëpagesat e të paktën** muajit te fundit. Kategorizimi i profesioneve të tyre është bërë bazuar në kodet e përcaktuara në VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP)”, e ndryshuar, si më poshtë:*

a) **3 (tre) Manovratorë / Operatorë** të makinerive të rënda: (Kodi LKP: Grupi 8342 ose Grupi 8343).

Kriteri: Duhet të paraqesin Dëshmi Aftësie Profesionale (DAP) për përdoruesit e makinerive të rënda, të lëshuar nga DPSHTRR ose institucione të autorizuar të formimit profesional, sipas Urdhrit të MIE nr. 200, datë 16.05.2019.

(Shënim: Në rastet e mjeteve me qira me staf, nuk kërkohet deklarimi në listëpagesa, burimi i tyre vërtetohet përmes kontratës së qirasë/shërbimit).

b) **1 (një) Shofer kamioni:** (Kodi LKP: 8332.01).

Kriteri: Shoferët e kamionit duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit te Transportit Rrugor, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente.

*(Shënim:*Në rastin kur këto punonjës janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

c) **1 (një) Betonues:** (Kodi LKP: Grupi 7114 - Betonues dhe punëtorë të lidhur me ta).

Kriteri: Duhet të figurojë në listëpagesat e të paktën muajit të fundit përpara datës së dorëzimit të ofertës nën kodin përkatës të LKP-së."

d) **2 (dy) Punëtor asfalti:** (Kodi LKP: Grupi 7119 - Punëtorë të tjerë të ndërtimit të strukturave dhe shtresave rrugore).

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre.

Kategorizimi i profesioneve të tyre është bërë mbi kodet e përcaktuara në VKM nr. 514, datë 20.09.2017 (Lista Kombëtare e Profesioneve), duke u përshtatur me mjetet e kërkuara dhe volumet e kantierit si më poshtë:

Manovratorët (Grupi 8342/8343): Janë të domosdoshëm për operimin e ekskavatorit/fadromës gjatë gërmimit dhe largimit të dherave, si dhe për rrulat ngjeshës dhe makineritë e asfaltimit. Angazhimi i tyre garanton ngjeshjen dhe shtrimin mekanik të saktë të shtresave të agregatëve dhe asfalteve sipas kuotave. Kërkesa bazohet në Urdhrin e MIE nr. 200/2019 për të garantuar sigurimin teknik në kantier.

Shoferi i kamionit (Kodi 8332.01): Kërkohej për transportin e materialeve inerte dhe sjelljen në kantier të përzierjes asfaltike të nxehtë në koordinim me grafikun e punimeve.

"Betonuesi (Grupi 7114): Përfshirë në strukturën minimale të personelit për të mbuluar proceset specifike, por me volum të reduktuar, që lidhen me punimet e vogla dhe lokale të betonit në trupin e rrugës, mbushjet apo sistemimet e nevojshme ndihmëse sipas projektit të zbatimit të hartuar nga studio 'LENI-ING' shpk. Përcaktimi i këtij kodi në përputhje me VKM nr. 514/2017 (LKP) është bërë në raport të drejtë me këto zëra të preventivit, duke garantuar se operatori ka një punonjës të kualifikuar për këto ndërhyrje, pa krijuar ngarkesë të tepërt apo disproporcionale për pjesëmarrësit në garë."

Punëtori i asfaltit (Grupi 7119): Ka rol kyç në fazën e shtrimit të asfalteve për kryerjen e hapjes manuale të përzierjes asfaltike në pikat e ngushta ku makineritë nuk kanë hapësirë manovrimi, përpara ngjeshjes finale.

Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore dhe listëpagesat E-Sig shërbejnë si mjet objektiv për të certifikuar kapacitetin real dhe organik të operatorit përpara lidhjes së kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri I përcaktuar i punonjësve është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda **6 muajve** kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 216 datë 13.04.2023 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre".

3.7	Shkulje rrenjeve bimeve te vogla	m2	3,715.0								
	Sp+p	op		743.00				92.88	30	3.10	
3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, token zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	822.0								
	Ekskavator 0.25 m3	op				89.60		11.20	60	0.19	
3.45/1	Germim kanalesh ne token te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m²	m3	11.0								
	Punetori e thjeshte (paga bruto +kontributet)	op		66.44				8.31	60	0.14	
3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	833.0								
	Transport me auto vetshkarkuese 5 km	t/km			7,497.00			0.00		#DIV/0!	
3.183/a	Shtrese zhavor lumi t=10cm	m2	251.5								
	Sp+p	op		32.69				4.09	60	0.07	
	Grejder	op				5.03		0.63	60	0.01	
	Zhavor lumi	m3					27.7				
3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2	16,717.5								
	Sp+p	op		1,671.75				208.97	60	3.48	
	Grejder	op				334.35		41.79	60	0.70	
	Autobot	op				334.35		41.79	60	0.70	
	Rul (kompresor) me vibrim	op				752.29		94.04	60	1.57	
	Stabilizant	m3					3,343.50				
3.711	Shtrese Stabilizanti 8 cm	m2	4,829.5								
	Sp+p	op		241.48				30.18	60	0.50	
	Grejder	op				96.59		12.07	60	0.20	
	Autobot	op				86.93		10.87	60	0.18	
	Rul (kompresor) me vibrim	op				193.18		24.15	60	0.40	
	Stabilizant	m3					482.95				

3.229/1	Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri	m2	11,888.0								
	Sp+p	op		1,295.79				161.97	90	1.80	
	Autobitumatriçe	op				11.89		1.49	90	0.02	
	Asfaltoshtruese	op				118.88		14.86	90	0.17	
	Rul (kompresor) me vibrim	op				118.88		14.86	90	0.17	
	Binder me zall e rere lavatrice	ton					1,307.68				
	Bitum M-3 (leng)	kg					5,944.00				
3.224/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri	m2	11,888.0								
	Sp+p	op		974.82				121.85	90	1.35	
	Autobitumatriçe	op				11.89		1.49	90	0.02	
	Asfaltoshtruese	op				83.22		10.40	90	0.12	
	Rul (kompresor) me vibrim	op				83.22		10.40	90	0.12	
	Asfaltobeton guri kave	ton					820.27				
	Bitum M-3 (leng)	kg		5,944.00							
3.243	Struktura monolite betoni C 16/20	m3	6.0								
	Sp+p	op		76.80				9.60	60	0.16	
	Vibrator thellesie	op				9.84		1.23	60	0.02	
	Betonjere 500 liter	op				3.90		0.49	60	0.01	
	Cimento 32.5 N	kg					1,644.00				
	Rere e lare lavatrice	m3					2.76				
	Kallep themele e mure me derrasa te veçuara	m2					32.40				
	Uje teknologjik	l					1,200.00				
	Zall (granil) lavatrice	m3					4.74				
2.426/2	Prishje mur blloqe betoni	m3	1								
	Punetori e thjeshte (paga bruto +kontributet)	op		3.3				0.41	30	0.01375	

3.942/1	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente (paste)	ml	7,430.0								
	Sp+p	op		743.00				92.88	30	3.10	
	Sperkates boje per vizime ne rruge	op				743.00		92.88	30	3.10	
	Boje bikomponente (paste)	kg					6,241.20				
3.955	FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë	1.00								
	Sp+p	op		0.50				0.06	30	0.00	
	Tabele rrugore D=60cm	cope					1.00				
3.616/a	F V bordura betoni 10x20cm (Per kanale uje shiu)	ml	266.0								
	Sp+p	op		212.80				26.60	30	0.89	
	Cimento 32.5 N	kg					1,197.00				
	Rere lumi	m3					4.79				
	Bordura betoni 15x25 cm	m					266.00				

Totali I materialeve qe do te transportohen	12420 ton
Afati I punimeve	180 dite
Sasia e transportuar ne dite	69 ton/dite
Rruge kamioni ne dite	7 rruge
Sasia max. e transportuar per 1 rruge	10 ton
Kamionat qe nevojiten per transportin e 69 ton ne dite	1 kamion 10 ton

Numri i manovratorëve dhe shoferëve të kamionit është përcaktuar nga numri i makinerive që janë të domosdoshme për kryerjen e punimeve, 6 makineri dhe 1 kamionë, si dhe mbështetur në bashkërendimin dhe mbivendosjen e proceseve të punës sipas grafikut të zbatimit të punimeve.

2.4 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

Nr	Mjetet	Sasia	
1	Mjet transporti veteshkarkues ≥ 10 ton (kapac. mbajtes)	1 cope	Në pronësi ose me qera
2	Eskavator	1 copë	Në pronësi ose me qera
3	Grejder	1 copë	Në pronësi ose me qera
4	Autobot	1 copë	Në pronësi ose me qera
5	Rul me vibrim	2 copë	Në pronësi ose me qera
6	Autobitumatrice	1 cope	Në pronësi ose me qera
7	Asfaltoshtruese	1 cope	Në pronësi ose me qera
8	Vibrator thellesie	1 cope	Në pronësi ose me qera
9	Betonjere 500 liter	1 cope	Në pronësi ose me qera
10	Sperkates boje per vizime ne rruge	3 cope	Në pronësi ose me qera

Si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në momentin e dorëzimit të ofertës në sistemin elektronik:

Për mjetet në pronësi që regjistrohen në regjistra publikë (DPSHTRR): Kopje të vlefshme të lejes së qarkullimit të mjetit, certifikatës së kontrollit teknik (SGS) të vlefshme, siguracionit të mjetit të vlefshëm, si dhe certifikatën për transport mallrash brenda vendit (për mjetet e transportit).

Për mjetet në pronësi që NUK regjistrohen në regjistrat publikë: Dokumentin që vërteton pronësinë e tyre (akte të zhdoganimit në RSH ose fatura tatimore të blerjes).

Për mjetet e marra me qira: Kontratën përkatëse të qirasë (noteriale ose nënshkruar me nënshkrim elektronik sipas ligjit) ku të specifikohet objekti dhe afati i saj që mbulon periudhën e zbatimit të kontratës. Kontrata e qirasë duhet të shoqërohet detyrimisht me dokumentacionin e pronësisë të qiradhënësit (leje qarkullimi, SGS, siguracion ose faturë blerje/zhdoganimi sipas llojit të mjetit).

Deklaratë Disponueshmërie: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se të gjitha mjetet e mësipërme do të vihen në dispozicion të plotë të këtij projekti sipas grafikut të punimeve. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Rregullat e Prokurimit Publik në fuqi.

*(Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues).*

Mbështetur në nenin 26, pika 6 e VKM-së nr 285 , date 19.05.2021, në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e suksesshëm të objektit të prokurimit.

Lista e mjeteve dhe makinerive është përpiluar në raport të drejtpërdrejtë me afatin e zbatimit të kontratës dhe volumet specifike të preventivit të hartuar nga studio projektuese “LENI-ING” shpk. Gërmimi dhe nivelimi (Ekskavatori, Grejderi, Rruli dhe Autoboti) formojnë trupin e rrugës dhe ngjeshin nënshtresat. Mjetet e asfaltimit (Autobitumatricja dhe Asfaltoshtuesja) sigurojnë shpërndarje uniforme të emulsionit dhe shtrim mekanik me temperaturë të kontrolluar. Mjetet e transportit dhe betonimit (Kamionët, Betonierja dhe Vibratori) janë të domosdoshme për transportin në rrugë të brendshme të ngushta dhe derdhjen e strukturuar të betonit për kanalet anësore, ndërsa spërkatësi i bojës kërkohet për fazën finale të sinjalistikës horizontale.

Kërkesa për paraqitjen e lejeve të qarkullimit, kontrolleve teknike (SGS) dhe certifikatave të transportit synon të provojë që mjetet janë në gjendje të rregullt pune dhe ligjërish të gatshme për t'u angazhuar në kantier që në momentin e lidhjes së kontratës, duke shmangur vonesat në grafik. Detyrimi për ngarkimin e tyre në sistem që në momentin e dorëzimit të ofertës bazohet në rregullat e përditësuara të prokurimit elektronik, duke garantuar transparencë dhe trajtim të barabartë të të gjithë operatorëve në garë.

2.5 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) t'iu përkasin fushës së aktivitetit të OE-ve, që përkon/përputhet me objektin e prokurimit, si me poshte:

- **a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme)/ekuivalent:** E akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO sipas*

zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit).

Argumentimi:

Kërkesa e cilësisë është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1, si dhe në zbatim të Nenit 44, pikat 1 dhe 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se kërkesa për certifikata të vlerësimit të konformitetit lejohet vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001:2015 i referohet sistemeve të menaxhimit të cilësisë dhe strukturave të organizimit të ndërmarrjeve. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me këtë certifikim me qëllim garantimin e efikasitetit dhe efektshmërisë në menaxhimin e kantierit për objektin “*Sistem, Asfaltim rruga Shelqet-Kace*”. Ky certifikim siguron që operatori aplikon standarde të kontrollit të cilësisë në menaxhimin e burimeve dhe proceseve të ndërtimit, gjë që minimizon riskun për defekte teknike dhe garanton që punimet e asfaltimit dhe gërmimit të ofrohen sipas standardeve të kërkuara të tregut.

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit, të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit prej 6 muajsh kalendarikë.

Argumentimi:

Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3. Paraqitja e grafikut të detajuar është e domosdoshme për të vërtetuar aftësinë organizative të operatorit dhe përputhshmërinë e hapave teknologjikë të zbatimit (gërmim, shtresë çandërr/stabilizant, asfaltim) me afatin total prej **6 muajsh** të përcaktuar në projekt-zbatimin e studio “LENI-ING” shpk.

2.7 Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë me Landfillin Bushat, të vlefshme për depozitimin e mbetjeve inerte që krijohen gjatë punimeve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr 10463/2011” Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; Ligji nr 10431/2011” Për mbrojtjen e mjedisit”; nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri lidhet me nevojën për administrimin e ligjshëm të mbetjeve që krijohen gjatë realizimit të kontratës. Ky kriter lidhet me kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit ekonomik për realizimin korrekt të kontratës, pasi siguron që mbetjet e krijuara nuk do të depozitohen në mënyrë të paligjshme apo të pakontrolluar, duke shmangur ndotjen e mjedisit dhe pasojat administrative apo penale që mund të rrjedhin nga mosmenaxhimi i tyre, gjithashtu në

preventiv përfshihen punimeve germimi, transport materialesh, prishje etj. **Kriteri është proporcional dhe i domosdoshëm për natyrën e objektit të prokurimit, pasi garanton që operatori ekonomik ka të siguruar paraprakisht destinacion të autorizuar për trajtimin/depozitimin e mbetjeve.**

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

- ❖ **Për sa i përket specifikimeve teknike, lihet mundësia të paraqitet dhe standartet SSH/UNI/EN/ISO, sipas rastit që aplikohet.**